



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE LEGJISLACIONIT

Nr. 1956 Prot.
2

Patos, më 03.07 /2025



MIRATOHET
KRYETARI
Faton Duro

Lënda: Për miratimin e listës së Të Dhënave Të Hapura.

Në bazë të pikës 2 të neni 8, të nenit 9 pika 1/1 shkronja “b” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin e konsultimit publik”, ligjin nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 127, datë 25.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe propozimit të grupit të punës për miratimin e Të Dhënave të Hapura si më poshtë;

- **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit**
 1. Struktura organizative
 2. Rregulloria e brendshme
 3. Organigrama
 4. Rregulloria e parandalimit të konfliktit të interesave
 5. Kodit etik dhe i sjelljes së punonjësve të Bashkisë Patos
 6. Plani vjetor i pranimi në shërbimin civil
 7. Shpalljet e pozicioneve vakante të institucionit
 8. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- **Drejtoria e Financës**
 1. Buxheti vjetor
 2. Buxheti afatmesëm
 3. Raportet e monitorimit
- **Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Mjedisit**
 1. Paketa fiskale
 2. Plani lokal i menaxhimit të mbetjeve
 3. Plani lokal i zhurmave në mjedis
 4. Vlerësimi i kapitalit natyror
 5. Plani lokal i zhvillimit të bujqësor
- **Sektori i Auditit të Brendshëm**

1. Plani vjetor dhe strategjik i auditimit të brendshëm
 2. Raporti vjetor i auditimit të brendshëm
 3. Plani i integritetit
 4. Raporti i monitorimit për planin e integritetit
 5. Njoftimi mbi Njësinë e Sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
- **Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Monitorimit të Shërbimeve**
 1. Plani i Përgjithshëm Vendor i Qytetit të Patosit.
 2. Dokumentacioni për t'u pajisur me leje ndërtimi/zhvillimi/certifikatë përdorimi/deklaratë paraprake.
 3. Dokumentacioni për licencimin e mjeteve të transportit.
 4. Investimet publike.
 5. Rregullore për administrimin dhe funksionimin e varrezave në Bashkinë Patos.
 6. Kriteret për licencimin e Agjencive Funerale.
 - **Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit**
 1. Plani social
 2. Lista e shërbimeve që ofron Qendra Multifunksionale
 3. Informacione mbi masat e përfitimit të Ndihmës Ekonomike apo pagesave të tjera si aftësia e kufizuar.
 4. Dokumentacioni dhe mënyra e aplikimit për të përfituar Ndihmën Ekonomike.
 5. Dokumentacionin dhe mënyra e duhur se si aplikohet për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar (për të gjitha kategoritë).
 6. Dokumentacioni dhe mënyra e duhur se si aplikohet për të përfituar bursë.
 7. Evidenca të ndryshme arsimore ndër vite.
 8. Lista e dokumentacionit për t'u regjistruar çerdhe/kopsht.
 9. Lista e institucioneve shtetërore/private që ofrojnë shërbime për kategori PAK, fëmijë, të moshuar dhe listën e dokumentacionit që kërkohet.
 10. Dokumentacioni dhe mënyra e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social.
 11. Informacion për përfitimin e Ndihmës Ligjore Falas.
 - **Spektori i Prokurime Publike**
 1. Regjistrin e parashikimeve të prokurimeve të Bashkisë Patos.
 2. Informacion mbi fondin limit për çdo investim.
 3. Informacion mbi kontratat e lidhura për çdo investim.

DREJTOR
Juela Shpata

